

**RAPORTI I MONITORIMIT TË FUSHATËS ZGJEDHORE**  
**TE PARTISE PAJTIMIT KOMBETAR SHQIPTAR**  
**PER ZGJEDHJET PER ORGANET E QEVERISJES VENDORE**  
**TE DATES 30.06.2019**

**I. INFORMACION I PËRGJITHSHËM**

**A. INFORMACIONI LIGJOR**

- i. Kuadri ligjor:

Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë dhe Ligji Nr 8580 date 17.02.2000 "Per Partite Politike" me ndryshimet e bera me Ligjin 90/2017, dhe aktet nenligjore te KQZ te miratuara per kete qellim.

  - a. Kohëzgjatja e misioniteshte nga data e lidhjes se kontrates, (01.06.2019), deri ne afatin ligjor te dorzimit te raportit te monitorimit, 26.11.2019).
  - b. Fushëveprimi i monitorimit: Kryerja e monitorimit te shpenzimeve te fushates zgjedhore te Partise Demokracia Sociale duke perfshire aktivitetet, veprimtarite dhe materialet e perdorura prej saj gjate fushates zgjedhore ne menyre ligjore, te paaneshme, transparent dhe profesionale ne perputhje me Kodin Zgjedhor, Ligjin Nr 8580 date 17.02.2000 "Per Partite Politike" me ndryshimet e bera me Ligjin 90/2017, dhe aktet nenligjore te KQZ te miratuara per kete qellim.
- ii. Kontrata e shërbimit eshte lidhur me date 01.06.2019 Nr prot 5061 midis Komisionit Qendror te Zgjedhjeve dhe Auditues Ligjor Valentina HAXHI.
- iii. Vendimi i KQZ-së nr 740 date 31.02.2019 "Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve financiarë dhe audituesve ligjorë të cilët do të kryejnë monitorimin dhe auditimin e fondeve dhe shpenzimeve të fushatës zgjedhore nga subjektet zgjedhore për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019"
- iv. Përgjegjësia jone eshte te shprehim nje opinion per koston e fushates elektorale mbi bazen e informacioneve te grumbulluara gjate procesit te monitorimit, si dhe te evidentojme respektimin ose jo te kerkesave qe percakton kuadri ligjor per ngjarjet e ndodhura gjate zhvillimit te fushates zgjedhore per organet e qeverisjes vendore te dates 30.06.2019.

## **B. PARAQITJA E RAPORTIT TË MONITORIMIT DHE STRUKTURA E TIJ**

- i. Partia Pajtimet Kombetar Shqiptar eshte nje parti politike e krijuar ne 04/12/1997. Selia e partise eshte ne Tirane ne adresen Rruga Arkitekt Sinani Pallati 60 Tirane. Kryetar i partise eshte Z. Spartak BODI.
- ii. Struktura dhe objekti i raportit të monitorimit
  - a. Zyrat zgjedhore
  - b. Aktivitetet, eventet dhe materialet e fushatës
  - c. Vlerësimi i respektimit të kërkesave ligjore nga ana e subjektit zgjedhor
- iii. Ne funksion te plotesimit te angazhimit te marre persiper, pas lidhjes se kontrates u perpoqa te takohesha me kryetarin e Partise Z Spartak DOBI,takim ky nuk u be i mundur nga Z. Spartak, kemi komunikuar ne telefon dhe me ka komunikuar qe nuk ka hapur asnje zyre elektorale.

Ne kuader te monitorimit u jemi drejtuar me shkrese bashkive te vendit, te percaktuara sipas njoftimit te derguar nga ana Juaj. Po keshtu i jemi drejtuar zyrtarisht Z Spartak Dobi, per te na vene ne dispozicion te gjithe informacionin e kerkuar nga ligji, por nuk na u be e mundur.

Ju kemi kerkuar informacion me shkrim per hapjen e zyrave zgjedhore, Bashkive Diber, Vlore, Elbasan, Tirane, Korce, Sarande, Shkoder, Tepelene, Berat, Durres, Gjirokaster, Fier, Kukes, Lushnje, Mallakaster, Permet.per te marre informacion. Na jane pergjigjur me e-mail Bashkite Diber, Berat, Tirane, Durres, na kane kthyer pergjigje me shkrese Bashkite: Vlore, Fier, Korce, Tepelene, Ne pergjigjet e ketij komunikimi,prej te gjitha Bashkive te siperpermendura eshte konstatuar se nuk kane marre njoftime nga ky subjekt elektoral per hapjen e zyrave zgjedhore dhe nuk kane asnje informacion per hapjen e ndonje zyre zgjedhore te Partise Pajtimet Kombetar Shqiptare ne teritorin e bashkive respektive. per fushaten zgjedhore per organet e qeverisjes vendore te dates 30.06.2019.

Ne shkuam ne Bashkite Kukes, Shkoder, Sarande, Lushnje, Fier, Mallakaster, Permet, Pogradec, Patos dhe konstatuam se Partia Pajtimet Kombetar nuk kishte hapur zyra elektoral ne asnje prej Bashkive te verifikuara madje as ne Bashkine Kukes.

- iv. Procesi i monitorimit te fushates zgjedhore per organet e qeverisjes vendore te dates 30.06.2019 filloi me biseden telefonike me Z. Spartak Dobi, kryetar i Partise.Nga informacionet e marra konstatuam se Partia Pajtimet Kombetar kishte regjistruar kandidat vetem ne keshilltare bashkiene Bashkine Kukes .Per nivelin e kryetareve te

bashkive nuk kishte paraqitur asnje kandidature. Nuk ishte hartuar ndonje plan shpenzimesh per fushaten elektorale mbeshtetur ne argumentin se gjendja e fondeve ne llogarine bankare ishte e paperfillleshme. Krahas marrjes se ketyre informacioneve eshte vazhduar me monitorimin ne terren.

**Tabela 1**

<b>1/ Identifikimi i subjektit zgjedhor në raportin e monitorimit</b>			
	a) identifikimi i subjektit zgjedhor (partia, kandidati/ja)	Po	Partia Pajtimit Kombetar
	b) identiteti i personit përgjegjës për financat	Po	Ferit Hoxha
	c) evidenca e çeljes së llogarisë bankare	Po	para 01.01.2019
	d) paraqitja e deklarimeve bankare që mbulojnë periudhën e fushatës	Po	Nuk ka veprime
<b>2/ Nënshkrimi dhe data e paraqitjes së raportit të monitorimit</b>			
	Eksperti financiar	Po	Valentina HAXHI
	Nënshkrimi	Po	25.11.2019
	Dorëzimi i raportit të monitorimit	Po	05.12.2019
<b>3/ Aktivitetet, eventet dhe materialet e monitoruara</b>			
	a) Zyrat zgjedhore	Po	Nuk jane hapur
	b) Respektimi i ndalimit të aktiviteteve zgjedhore edhe nga ana e bashkive.	Po	<i>Nuk jane konstatuar</i>
	c) aktivitetet		0
	d) eventet		0
	e) materialet propagandistike		0

## **A. ANALIZA**

### a/ Kërkesat formale

- Llogari bankare e veçantë
  - o Nukjane hapur llogaria bankare te veçantapër fushatën zgjedhore dhe për të marrë donacione që e kalojnë shumën prej 100,000 Lekë.

Nga komunikimi me subjektin dhe dokumentacioni i derguar nga Banka rezulton se Partia Pajtimet Kombetar te Shqiperise nuk ka llogari bankare te hapur .

rezultos se Partia PAJTIMIT KOMBETAR ka te hapur nje llogari ne Union Banke me IBAN AL72214111060111407553020218

Ka pasur nje llogari tek Raiffeisen Banke por eshte e mbyllur me Nr 010010695

Sipas Account Statementte derguar nga Banka per periudhen 01.01.2019 deri 30.06.2019 nuk rezulton te kete veprime bankare ne kete llogari.

- o Personi pergjegjes i financave eshte Z Ferit Hoxha.

- **Procedura verifikimi**

- o Eshte komunikuar nepermjet e-mail me Z. Ferit Hoxha per llogarite bankare qe jane hapur dhe funksionojne per subjektin elektoral Partia Demokracia Sociale.
- o Eshte komunikuar me Tirana Bank, me BKT, me ALPHA Banke, me Credins Bank te cilat kane konfirmuar faktin se subjekti nuk ka hapur llogari ne keto banka vetem nje llogari bankare per subjektin Partia Pajtimet Kombetar e cila perdoret per aktivitetin gjithvjeter te saj, pra nuk eshte llogari e hapur per fushaten elektorale, eshte tek Union Banke , ka pasue edhe nje tek Raiffeisen Banke por eshte e mbyllur si llogari.
- o Nuk ka informacion per ankesa te mbritura ne KQZ per kete subjekt zgjedhor.

Gjate monitorimit ne terren u kontaktua me personat pergjegjes ne Bashkite Kukës, Shkoder, Sarandë, Pogradec, Mallakaster, Fier, Patos, Lushnje , dhe Permet. Si nga pergjigjet e dhena me shkrim nga shume prej Bashkive te kontaktuara, ashtu edhe nga kontrolli ne terren dhe informacione te medias, nuk u konstatuan zyra elektorale te hapura nga subjekti zgjedhor Partia Pajtimet Kombetar Shqiptar, nuk ka materiale propogandistike te afishuara dhe nuk u konstatua zhvillimi i eventeve elektorale.

Per kete arsye, (megjithese eshte kerkese e modelit te raportit te monitorimit te miratuar nga KQZ), nuk eshte e nevojshme te bashkangjiten tabela analitike per zyrat elektorale pasi nuk u konstatua se jane hapur, per evente elektorale pasi u konstatua se nuk jane zhvilluar te tilla, dhe per materiale propogandistike, pasi edhe ato nuk u konstatua se jane prodhuar ose perdorur.

**Ne perfundim te vzhgimeve dhe dokumentave te siguruara gjate procesit te monitorimit konkludojme se gjate zhvillimit te fushates zgjedhore per organet e qeverisjes vendore te dates 30.06.2019 nga subjekti elektoral Partia Pajtimet Kombetar Shqiptar :**

**Nuk jane konstatuar shkelje te Kodit Zgjedhor ne hapjen e zyrave elektorale,**

**Nuk jane konstatuar shkelje te Kodit Zgjedhor ne perdorimin e materialeve propogandistike, apo organizimin e eventeve elektorale.**

**Kostua e zhvillimit te fushates elektorale nga subjekti zgjedhor Partia Pajtimet Kombetar Shqiptar per fushaten zgjedhore per zgjedhjet ne organet e qeverisjes vendore eshte 0 leke**

